



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2012

RELACION

Lënda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të KMDP-se për 9- mujin 2012

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatimin e buxhetit të vitit 2012, është mbështetur në kërkesat me të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektesë në zbatim të Ligjit nr.10487 datë 05/12/2011”Për buxhetin e vitit 2012”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.2, datë 6/02/2012”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit “ si dhe Udhëzimit nr.2/1 datë 15/02/2012,”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012’,

Në mbështetje të Ligjit nr. 10487 datë 05/12/2011”Për buxhetin e vitit 2012” ,për vitin 2012, është miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 1 program buxhetor :

- Programin me emertimin « Planifikim, menaxhim dhe administrim » ku përfshihet i gjithë buxheti i akorduar për funksionimin e aktivitetit të Zyres së Komisionerit për mbrojtjen e të Dhënave Personale

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) së hartuar gjatë procesit të PBA 2011-2014 . Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në KMDP Mbështetja, organizimi, krijimi i kushteve të nevojshme për mirëfunksionimin e KMDP, përafrimin e harmonizimit legjislativ në fushën e të dhënave personale me legjislativin e vendeve të tjera të komunitetit evropian, me të drejtën komunitare si dhe privatesinë, imponimi i legjislativit të sotëm ekzistues vendas si dhe ndergjegjesimin dhe shtrirjen e fushës së zbatimit të ligjit në të gjithë vendin duke garantuar një transparencë totale të përpunimit dhe garantimit të të dhënave , siguri maksimale të të dhënave personale ,intensifikimi i marrëveshjeve me strukturat e BE duke garantuar maksimalisht mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve në levizje ose rezident në BE. administrimi e menaxhimi i regjistrit elektronik dhe fizik të subjekteve kontrollues, monitorimin, rekomandimin dhe investigimet në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave personale, mbi të cilat KMDP zhvillon përgjegjësitë e saj ligjore, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut .

Në zbatim të udhëzimit nr,2/1 datë 15/02/2012, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012", kreu 6-Raportet e Monitorimit, pika 254,256,257, po ju raportojme mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar-Shtator 2012, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndermarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave personale, në bazë dhe për zbatim të regjstrit të parashikimeve të vitit 2012, për periudhën 9 mujore ka prokuruar:

KMDP i është akorduar një fond i planifikuar prej **45.177 . në mijë leke**, me ndryshimet e rialokimeve përbehet nga:

Fondi i Pagave:	27.651 mijë leke (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	4.754 mijë leke (zeri 601)
Fondi për Shpenzime Operative	9.310 mijë leke (zeri 602)
Fondi për Investime:	3.000 mijë leke (zeri 231+230)
Transferime korrente	458 mijë leke (zeri 606)
Kuotizacione	87 mijë leke (zeri 605)

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave personale, ka realizuar vlerën buxhetore në **31018 në mijë lekë** ose 68%, të fondit të planifikuar vjetor. ose 88 % të fondit të parashikuar për 9-mujorin 2012.

I-Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zeri 600-601), është realizuar, në zbatim të strukturës organizative të miratuar, Nr. 225 dtatë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës, organikes dhe katekorizimit të pagave të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale numri mesatar i punonjësve është realizuar 28 vetë, nga 29 vetë të miratuar. Shmangiet nga planet kanë ardhur si rezultat i ripërshërimit të procedurës së rekrutimitit,. Pas ndjekjes së procedurave të rekrutimit (2 here radhazi) kandidatet e testuar, nuk arritën të vlerësoheshin në nivelin minimal të mjaftueshëm për rekrutim. Në pozicionin e Specialistes pranë Dejtorisë së Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marëdhënies me Jashtë .Referuar V.K.M nr 589, date 05/09/2012 "Mbi disipalinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012 " ,pika 3, mbi ngrirjen deri në fund të vitit të çdo funksioni të miratuar në organike, nuk ka filluar asnjë procedurë e rekrutimit, gje e cila reflektohet dhe në mospërdorimin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore.

Shtesa e pagave duke filluar nga periudha 15 Korrik është reflektuar në pagat e shtatorit të cilat efektin e tyre financiar do ta kenë në raportimin e fundit të vitit.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht 19771 (në mijë lekë) për paga si dhe, 3018 (në mijë lekë) për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose 93 % e fondit të planifikuar 9-mujor ose 70 % kundrejt planit vjetor.

II-Fondi per shpenzim investime (zeri 231) , nga vlera e pergjithshme prej 3,000 (ne mije leke) per periudhen e raportuar, eshte prokuruar ne masen 901 (ne mije lekë)]

Gjate vitit 2012, objektivat prioritare ne drejtim te DSHM është dhe mbetet ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, udhëzimit nr.2 ”Për procedurën e blerjeve të vogla”, mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara e për investime e konkretisht janë realizuar investimet e mëposhtme.

- Ndjekja e procedurave “Blerjen orendi zyre”, për plotësimin e krijimin e kushteve të pershtashme të punës së punonjësve , mobilim të sallës së trajnimeve dhe studimeve ,arredim të ambientit të receptionit e pritjes së publikut dhe kontrolluesve publike e private.,si dhe të tjera pajisje të domosdoshme . Fondi i planifikuar në Projektin M890001 në shumën 520(në mije leke me TVSH), është realizuar në masen 426 (në mije leke) ose 81 % e fondit të planifikuar.Konkretisht :
- ✓ Kane përfunduar procedurat për blerjen dhe sistemimin e pajisjeve “orendi zyre “ në shumën 356 (ne mije leke) sipas destinacionit të mesiperm.
- ✓ Ka përfunduar procedura e prokurimit (me procedurën e blerjeve të vogla) e shtesës së funksionit të opsionit, në centralin telefonik , të sekretarisë telefonike , e cila mundëson komunikimin midis ambejntecve të brendshme dhe thirrjeve nga jashtë zyrës. Fondi i cili u realizua në shumën 70 (ne mije leke) ,brenda projektit “Pajisje zyre)
- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave të prokurimit për “Blerjen e pajisjeve kompjuterike “ është realizuar me procedurën e blerjeve të vogla blerja e pajisjes së serverit, e domosdoshme për mbajtjetjen e të dhënave në institucion në shumën 474 në mije leke. Pra për këtë projekt realizimi është në masen 99 % përkundrejt planit. Diferencat janë për efekt prokurimi.
- Ndjekja e procedurave me objekt prokurimi “Ndertimi i sistemit të menaxhimit të ceshtjeve të regjistrimit të kontrolluesve dhe procedurat e inspektimit “ alokuar nga ministria e Financave në Projektin “Intranet” në shumën 2.000 në mije leke , janë ndjekur procedurat e tenderimit me procedurën “Kerkese me propozim” . Kane përfunduar procedurat dhe është lidhur kontrata me firmën fituese MC Networking, në shumën 979 në mije leke e cila tashmë është në proces testimi dhe trajnimi të stafit. Ka përfunduar konfigurimi dhe pas testimit përfundimtar e marrjes në dorezim të softit do të kryhet edhe pagesa , reflektimi i se ciles në leke e perindje , do të ketë efektin e saj në muajin Nentor .

III- Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), për vitin 2012, pas ndryshimeve të kërkuara e të miratuara nga M.Financave ,për rialokim në zërat e kërkuar dhe shtesa në buxhet në fondin e vecante ,mban vlerën 9310 (ne mije leke) . Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej 6890(ne mije leke) ,rreth 94 % , e planit 9- mujor , duke respektuar kërkesat e detajuara në Regjistrin e Prokurimeve Publike, të miratuara edhe nga Agjensia e Prokurimeve Publike. Si vjetor realizimi shtet në masen 74 % .

Ne pasqyren sipas **Formatit Nr 6** eshte paraqitur plani vjetor si dhe realizimi vjetor në nivel programi, e ndarë sipas zërave kryesore të buxhetit. Si plani 9- mujor dhe realizimi 9- mujor përputhen me shifrat e dhëna dhe të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Formati nr 7-Aneksi 9

Realizimi dhe monitorimi i përdorimit të fondeve publike në nivel të përgjithshëm programi dhe realizimi ka qënë në masën 68 %.kundrejt vjetorit ose 88% kundrejt 9- mujorit. .

Aneksi nr 9

Formati nr 8

Ne kete format eshte paraqitur realizimi i produkteve(ne sasi) nga kryerja e aktiviteve ne zbatim te objektiveve dhe strategjise së miratuar për vitin 2012.

Konkretisht :

Persa i perket **produktit F Shërbime te pergjithshme dhe infrastrukture** ,realizimi eshte shprehur vlerë dhe numër. Në vlere në këtë produkt jane perfshire sigurimi i shërbimeve të përgjithshme per të gjithë personelin , si furnizimi me uje, drita , telefon, sherbime sigurimi, sherbime abonimi per gjithë stafin si dhe furnizimi me mallra e sherbime te mbarevajtjes se punes se perditshme,kanceleri ,sherbime transporti, Gjithashtu pjese e saj eshte dhe ofrimi dhe krijimi i kushteve sa më të mira pune, nepermjet pajisjes se cdo punonjesi me asetet e nevojshme (orendi,informatike etj). Në numër eshte berë një ndrsyhim (per ta identifikuar e pasqyruar me sa me transparence shpenzimet e kryera sipas zerave te klasifikimit ne buxhet.)

Sqarojme se numri i shërbimeve te pergjithshme të ofruara e të permirësuara është dhenë në numër muajsh për 29 punonjës .

Produkti A Sherbime ligjore ,njesia matëse e se ciles eshte nr.aktesh. Referuar komenteve te MF per tremujorin e pare ,ne realizimin e ketij produkti sqarojme se per 9- mujorin 2012 jane dhëne mendime per akte ligjore e nenligjore gjithsej 20 mendime nga fusha e legjislacione te ndryshme. Në kuader të përfaqesjes së legjislacionit të brendshem me Ligjin 9887, datë 10.03.2008, jane studiuar aktet e miratuara në Fletoret Zyrtare

Në bashkëpunim me ekspertët e Projektit ,në kuader të asistences teknike per hartimin e akteve ligjire e nenligjore ne perputhje me ligjin per mbrojtjen e te dhenave personale . jane hartuar **dhe miratuar 5 udhëzime** ne fusha te ndryshme e konkrketisht “Rregullimin e maredhenieve mes kontrolluesve dhe perpunuesve te te dhenave ne rastet e delegimit te tyre”,’perpunimin e te dhenave personale ne sistemin bankar”,’peprunimin e te dhenave personale ne kuadrin provave klinike te barnave”,’percaktimi i rregullave per ruajtjen e sigurise se te dhenave personale te perpunuara nga kontrolluesit e medhenj”.’ percaktimi i rregullave per ruajtjen e sigurise se te dhenave personale te perpunuara nga kontrolluesit e vegjel”

Për këtë produkt bëjme me dije se deri ne miratimin e akteve te Komisionerit,Udhezime e hartime të kodeve me institucione në sektore të vecantë, kryhen nje serë veprimtarish si studim legjislacioni,

hartim projekt udhëzimesh, perkthime, dhënie e marrje mendimi ,të cilat kërkohen afatet e tyre kohore deri në finalizimin, miratimin e publikimin e tyre.

Eshte miratuar Manual i Komunikimit te jashteme te brendshem i KMDP-se ne bashkepunim me ekspertet e projektit IPA 2009.

Aktualisht jane pergatitur 2 perojekt udhezime te cilat jane derguar per mendim ne insitucionet perkatese ,së bashju me relacionet spjeguese.

Janë hartuar **dhe nënshkruar 2 mareveshje bashkepunimi** (të cilat tashme jane lidhur) me Autoritet homologe te Ukraines,Kosoves,Malit te zi dhe Bullgarisë. Si dhe 1 mareveshje është ne projekt me **Banken e Shqipërisë** .

Jane dhene kontribute dhe raporte në dy Ministri lidhur me PKMZSA-në .

Jane duke u trajtuar **1 kërkesa** për dhënie të Autorizimit të transferimit Ndërkombëtar të të dhënave Personale..

Produkti B lidhur me ndergjegjesimin dhe rritjen e shkalles së tij si për të rinjtë (duke përfshirë kategoritë e shkollave 9 vjecare ,të mesme të larta) si dhe opinionin në kuptim të Ligjit të quajtur subjekte .

Ndërgjegjësimi është një proces i gjatë dhe i vështirë. Ai nuk mund të matet dhe nuk ka standarte vendase apo dhe të huaja për nivelin e tij. Sqarojmë se këtë numër e kemi vendosur vetem për pjesëmrrerit aktual në organizimin e aktiviteteve , por që mund të arsyetojme se cdo përfaqësues në keto evente mund të perfaqesoje në kategori më të madhe. Ndoshta në vitet më pas mund të nxjerrim nje statistikë lidhur me të.

Ky produkt realizohet nëpërmjet **Seminareve ndërgjegjesuaes** i cili mund të jetë në vetevete një matës apo indikator mbi performancën e Drejtorisë së Maredhenieve me Publikun. Identifikohen sa tillë jane parashikuar dhe sa janë realizuar. Sa pjesëmarrës kanë qenë të interesuar dhe të sensibilizuar.

Vlen për tu përmendur dhe kontributi i projektit IPA 2009, në organizmime dhe pjesëmarrje në keto subjekte.

Per peridhen në të cilen raportohet gjithsej jane realizuar 11 organizime me një pjesëmarrje rreth 1320 pjesëmarrës(në qytetin e Tiranës e në mjaft rrethe të ndryshme) .Kjo tregon një realizim të kenaqshem të ketij produkti.

Keto organizmie jane asistuar nga projekti IPA 2009, ku ndër të tjera bashkepunime kanë dhënë ndihmesën në plotesimin,grumbullimin dhe nxjerrjen e rezultateve të testeve ,në lidhje me njohurite e fituara gjatë organizimit të këtyre aktiviteteve

Produkti C : Kontrollues publike e private të sensibiluar në fusha të ndryshme

Ky produkt është vendosur me njesine matëse “ nr, kontrolluesish të trajnuar” nëpërmjet seminarëve të organizuar në rrethin e Tiranës si dhe në rrethe të ndryshme të vendit

Pjesë e ktij produkti janë dhe takimet ,tavolinat e rrumbullakëta ,seminaret e organizuara pranë ambejnteve të zyrave të Komisionerit me kontrollues të fushave të ndryshme apo dhe semanre jashtë

zyrave në ambiente sallash, të mundsuara nga Projekti IPA 2009, “Forcimi i Zyres së komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale “e konkretisht projekti FIIAPP-PROGECO,

Numri i eventeve të tilla janë 16 me një pjesëmarrje rreth 805 kontrollues publike e private .

Vlen për tu përmendur dhe angazhimi i institucionit në programet e trajnimit, me përfaqësues të kontrolluesve publike , pranë ITAP-it. Cdo muaj janë organizuar 2 ditë trajnimi me temën “Mbrojtja e të Dhenave personale “ ku ka patur një interes të madh nga pjesëmarrësit.

Gjithashtu në kuader të sensibilizimit dhe ndërgjegjesimit janë marrë kontakte të vazhdueshme me mediat , ku janë dhënë konferenca për shtyp mbi veprimtarinë e Zyres së komisionerit. Të cilat janë transmetuar dhe në edicione të lajmeve

Produkti D “Subjekte të regjistruar” njësia matëse e së cilës është **numri i regjistruarish** subjektsh private e publike, është pjesë e një veprimtarie të gjere identifikimi, plotësimi i informacionit për deklarim të zyrtar, vlerësime ligjore të përpunimit të të dhenave personale të cilat do të përbëjnë bazën për evidentim të shkeljeve e shmangie nga përpunimi i ligjshëm dhe burim për hetim të mëtejshëm, marrëveshje institucionale me subjekte publike apo privatë për vendosjen e urave të komunikimit për sensibilizimin për njoftim, kontakte me media të shkruar e publikime të ndryshme deri në dorëzimin e formularit të njoftimit përfundimtar dhe regjistrimin në regjistrin e publikut , i cili është burimi i vetëm online i informacionit për tu konsultuar me të , me qëllim informimin masiv dhe bërjen transparente ndaj publikut se kush përpunon, pse dhe si.

Numri i njoftimeve është rritur si pasojë e organizimit të seminareve sensibilizues por dhe dhenie të asistencës teknike lidhur me plotësimin e formularit të njoftimit, direkt me kontrolluesit publike e kryesisht me ato arsimore. Në kuader të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit ka funksionuar më së miri dhe me efektivitet ndërmarrja e takimeve të tilla në qytetin e Tiranës por kryesisht në rrethet e ndryshme si Pogradec, Korce, Shkoder, Elbasan, Vlore, Peshkopi,

Numri i njoftimeve për 9-mujorin është 1163 dhe i të regjistruarve 904

Produkti E Inspektime dhe trajtim ankesash, njësia matëse e të cilit është numër, është pjesë e një veprimtarie të gjerë e cila përfshin kontrolle tematike të planifikuara, publik apo private ,si dhe hetim e trajtime mbi bazë ankesash të ardhura në formë të ndryshme , monitorime e ndjekje rekomandimesh të vendosura nga Zyra e KMDP, monitorime të regjistrit të njoftimeve dhe në rast mos deklarimi të këtij detyrimi ligjor, indicje për vendosje të masave administrative me gjobë, e në përfundim ndjekja e procedurave për ekzekutim të tyre

- Jane trajtuar gjithsej për 9 mujorin **21 ankesa** ,
- Jane kryer **kontrolle të plota administrative për 9- mujorin 23**
- Në kuader të realizimit të objektivave ka vijuar puna për **kontrollin për ndjekjen e rekomandimeve** të lëna nga kontrollet e ushruar për vitin 2011 si dhe 2012 të cilat për 9-mujorin e vitit 2012 janë në **numrin 20** në kontrollues të ndryshëm publike e privatë në Qytetin e Tiranës si dhe në rrethet e ndryshme.
- **Inspektimet janë kryer edhe mbi bazën e njoftimeve** dhe për plotësimin e detyrimit për njoftim të cilat rezultojnë të jenë në **nr. 30**, brenda apo jashtë qytetit të Tiranës.

Sqaroj se në **produktin G-Pjesëmarrje ne Konferenca Nderkombetare** –është identifikuar si produkt me vete ,si në sasi dhe ne vlere , për vetë faktin për të zhveshur nga shpenzimet e shërbimeve të Pergjithshme që ofron dhe jane të kostuar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse . Pjesa e kostimit të **Menaxhimit të Lartë** identifikohet me qarte me shpenzimet e zërit **602-Mallra e shërbime –Dieta me jashtë** –pjesa me e madhe e së cilës shkon për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjens në keto evente të rëndesishme për ecurine,aderimin dhe afirmimin e insitucionit në rang Ndërkombëtar.Kryesisht përfaqesimi është i nivelit të lartë.

Formati nr 9

Ne kete format është paraqitur realizimi i produkteve(në vlere) nga kryerja e aktiviteve në zbatim të objektivve dhe strategjisë së miratuar për vitin 2012.

Për cdo produkt është përfshirë kosto e shpenzimeve për paga, sigurime, si dhe shpenzimet operative direkte të pjesëmarrjes.

Në komentet e 3- mujorit të pare të vitit 2012, ku në formatin 9 jane listuar 6 produkte(në vlerë) dhe në formatin 8(në sasi) janë listuar 8 produkte.

Sqaroj se **Produkti B-C**(në vlerë) Form 9 - është identifikuar në1 produkt „**Sensibilizim , ndergjegjesim, i kontroluesve dhe subjekteve**” ndërsa tek Formatit 8 jane dhënë të ndarë për të patur një performance dhe identifikim më transparent te fondeve publike te shpenzuara per cdo produkt si dhe realizimin e tyre ne sasi, te cilët janëaktivitetet për cdo grup - Subjekt të të dhënave apo Kontrollues publike e private –të cilet kane dhe detyrimin për njoftim dhe regjistrim.

Gjithashtu në **produktin F-Shërbime të pergjithshme dhe infrastruktura e ofruar dhe përmiresuar** e cilësuar në formatin nr 9, e kam ndarë në sasi në formatin nr 8 –për ta identifikuar me vete pjesën e infrastrukturës dhe vec pjesën e mallrave e shërbimeve të pergjithshme për cdo punonjës. Njesai matese eshte shprehur me nr.pajisjesh (orendi e te tjera zyre) dhe 1 shërbim (mallra e shërbime te ofruara) për të 29 punonjesit.

Sqaroj se në **produktin G-Pjesëmarrje ne Konferenca Nderkombetare** –është identifikuar si produkt me vete ,si në sasi dhe ne vlere , për vetë faktin për të zhveshur nga shpenzimet e shërbimeve të Pergjithshme që ofron dhe jane të kostuar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse . Pjesa e kostimit të **Menaxhimit të Lartë** identifikohet me qarte me shpenzimet e zërit **602-Mallra e shërbime –Dieta me jashtë** –pjesa me e madhe e së cilës shkon për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjens në keto evente të rëndesishme për ecurine,aderimin dhe afirmimin e insitucionit në rang Ndërkombëtar.Kryesisht përfaqesimi është i nivelit të lartë.

Gjithsej është marrë pjesë në 5 organizime të Konferencave Ndërkombetare dhe takime të radhës ne mjaft vende ,me pjesëmarrës të Atorteteve të mbrotjes së te dhënave Personale, si Luksemburg,Hungari,Amsterdam,Mali i zi , Maqedoni

Drejtoresha e Shërbimeve Mbështetëse (Nëpunëse Zbatuese)

Lindita Morina

